



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400-22788 të dates 10.06.2020 të Shoqatës së Minatorëve Pensionist Invalid dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 200 € (dyqind euro), Shoqatës së Minatorëve Pensionist Invalid dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400-22788 të dates 10.06.2020, për realizimin e nevojave të ndryshme financiare në mënyrë që të funksionojnë si zyre pune për aktivitet e tyre gjatë vitit 2020.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Shoqatës së Minatorëve Pensionist Invalid dega në Lipjan, në nr. 1907001134031173 në BKT bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara e lartëcekura duhet të sjell dëshmi-faturë deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore më së largu me datë 25.12.2020.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Shoqata e Minatorëve Pensionist Invalid dega në Lipjan,

1Nr.400-22788

Lipjan, më 01.10.2020

